FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

ACID FOLIK

Tableta - 5 mg
(Acid folik)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Acid folik dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Acid folik
3. Si ta merrni Acid folik
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Acid folik
6. Informacion i mëtejshëm.

1. ÇFARË ËSHTË ACID FOLIK DHE PËRSE PËRDORET

Acidi folik ndodhet në ushqime (p.sh. në mëlçi, fasule të thata, bizele, thjerrëza, portokalle, shparguj, panxhar, spinaq etj.), kryesisht si poliglutamat folati i reduktuar. Ai mund t'i nënshtrohet hidrolizës, reduktimit dhe metilimit në aparatin tretës përpara se të përthithet. Acidi folik sintetik që merret nga goja është një monoglutamat dhe ai përthithet plotësisht pas përdorimit, madje edhe në prani të sindromit të keqpërthithjes. Acidi folik shfaqet në plazmë rreth 15 deri në 30 minuta pas marrjes nga goja; përqëndrimi maksimal në përgjithësi arrihet pas 1 ore. Acidi folik metabolohet në mëlçi. Nivelet normale në serum të acidit folik të përgjithshëm luhaten nga 5 deri në 15 ng/mL. Në përgjithësi nivelet në serum < 5 ng/mL tregojnë për pamjaftueshmërinë e acidit folik, kurse nivelet < 2 ng/mL zakonisht shpien në anemi megaloblastike. Pjesa më e madhe e metabolitëve të acidit folik shfaqen në urinë pas 6 orësh; në përgjithësi jashtëqitja përfundon brenda 24 orësh.
Acid folik përdoret në mjekimin e anemisë megaloblastike për shkak të pamjaftueshmërisë së acidit folik (që mund të shfaqet prej ushqimit të pamjaftueshëm, shtatzënisë, barnave antiepileptike etj.)
Acidi folik përdoret për parandalimin e gjendjeve me pamjaftueshmëri të folateve.
Mjeku juaj mund ta ketë dhënë acidin folik për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun tuaj në qoftë se doni të dini pse ju është dhënë Acid folik.

2. PËRPARA SE TË MERRNI ACID FOLIK

Mos merrni Acid folik në qoftë se:
- jeni alergjik ndaj acidit folik
- jeni alergjik ndaj ndonjërit prej përbërësve joaktivë të përmendur në fund të këtij fletëudhëzuesi
- keni anemi megaloblastike të shkaktuar nga mungesa e vitaminës B12 ose të padiagnostikuar
- keni sëmundje malinje.

Në qoftë se mendoni se keni ndonjë nga gjendjet e përmendura më sipër, mos i merrni tabletat, shkoni dhe flisni fillimisht me mjekun tuaj dhe ndiqni këshillat e dhëna.

Tregoni kujdes të veçantë me Acid folik
Acidi folik nuk duhet përdorur kurrë i vetëm për mjekimin e anemisë pernicioze dhe patologjive të tjera që rrjedhin nga pamjaftueshmëria e vitaminës B12, sepse ai mund të shkaktojë shfaqjen e degjenerimit subakut, të kombinuar, të palcës së kockave.

Marrja e barnave të tjera
Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë së fundmi barna të tjera, edhe ato pa recetë. Informoni mjekun tuaj në qoftë se jeni duke marrë ndonjë prej të mëposhtmëve:
- acid aminosalicilik
- kontraceptivë që merren nga goja
- metotreksat, trimetoprim (frenues të dihidrofolatreduktazës)
- sulfasalazinë, antiinflamator në sëmundjet e zorrëve dhe artritin reumatoid
- hidantoina, antiepileptikë
- antituberkularë
- alkool
- antagonistë të acidit folik.

Këto barna mund të ndikohen nga Acid folik, ose mund të ndikojnë në mënyrën se si ai vepron. Mund të keni nevojë të përdorni sasi të ndryshme të këtij bari ose të merrni barna të tjera. Mjeku ose farmacisti juaj do t'ju këshillojë.

Shtatzënia
Në qoftë se jeni shtatzënë ose po planifikoni një shtatzëni, pyesni mjekun tuaj para përdorimit.

Ushqimi me gji
Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se ushqeni foshnjen me qumësht gjiri. Megjithëse ekskretohet me qumështin e gjirit, është e pranueshme ushqyerja me qumësht gjiri e foshnjeve gjatë kohës së marrjes së acidit folik.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Tregohuni të kujdesshëm gjatë drejtimit të automjetit ose përdorimit të makinerive derisa të shihni se si Acid folik ndikon tek ju.

Informacion i rëndësishëm për disa nga përbërësit e tabletave Acid folik
Bari përmban laktozë. Në qoftë se keni intolerancë ndaj disa sheqernave, flisni me mjekun tuaj përpara se të merrni këtë bar.

3. SI TA MERRNI ACID FOLIK

Gjithmonë merrini tabletat Acid folik vetëm sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se ndjeni që efektet e acidit folik janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.
Këshillojmë që tabletat t'i merrni në të njëjtën orë çdo ditë.
Tabletat Acid folik duhet të gëlltiten të plota me një gotë ujë.

Për mjekimin e anemisë megaloblastike:
Tek të rriturit përdoret me dozë 5 mg / ditë (maksimumi 15 mg / ditë), për 4 muaj. Mjekimi më pas vazhdohet me 5 mg / ditë çdo 1-7 ditë (mesatarisht 1 mg / ditë në varësi të sëmundjes shkaktuese).
Tek fëmijët deri në 1 vjeç përdoret 0.5 mg / kg / ditë, ndërsa mbi 1 vjeç marrin dozat e të rriturve.
Profilaksia tek të sëmurët me hemolizë kronike ose me dializë përdoret 5 mg / ditë.
Profilaksia tek gratë shtatzëna dhe me fëmijë në gji përdoret 0.2 - 0.5 mg /ditë.
Megjithatë, mjeku juaj mund t'ju këshillojë të merrni një dozë tjetër në varësi të gjendjes tuaj dhe reagimit ndaj barit.
Mjeku juaj mund t'ju kërkojë të merrni Acid folik për një kohë më të gjatë. Pyesni mjekun tuaj për këshillë në qoftë se nuk jeni të sigurt për sa kohë duhet ta merrni.

Në qoftë se keni marrë më shumë Acid folik
Në qoftë se keni marrë më shumë Acid folik se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se keni harruar të merrni Acid folik
Në qoftë se harroni një dozë, merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë për të plotësuar dozën e harruar.
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Të gjitha barnat mund të shkaktojnë efekte anësore. Ndonjëherë ato janë serioze, shumicën e herëve jo. Mos u alarmoni nga kjo listë e efekteve të mundshme anësore. Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre.
Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore të mëposhtme ju shqetëson:
- reaksione alergjie – ekzantema, eritema
- nauze, fryrje barku
- efekte në sistemin nervor qendror, çrregullime të gjumit, irritim, depresion nervor, konfuzion dhe dëmtime të gjykimit (përfshirë dhimbje e gjoksit dhe aritmi).

Në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk janë të përmendura në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI ACID FOLIK

Mbajeni larg fëmijëve.
Mos e përdorni Acid folik pas datës së skadimit e cila është e shënuar në paketim.
Mos e ruani mbi 25°C!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Acid folik – tableta 5 mg
Lënda vepruese është acid folik.
Çdo tabletë përmban 5 mg acid folik.
Përbërësit e tjerë janë: amidon, laktozë, celulozë mikrokristalore, xhelatinë, talk, glikolat natriumi i amidonit.

Përmbajtja e paketimit
Kuti me 60 tableta.

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:

Sipas recetës së mjekut.

Përmbajtja. Kujdes.

Forma e tabletës.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim (MAT) dhe Prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Qershor 2015.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.